



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Konferenca e Kryetarëve

PROCESVERBAL

Tiranë, më 29.05.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i projektprogramt të punës së Kuvendit për periudhën 3 qershor – 12 korrik 2019
2. Miratimi i projektkalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 3 - 21 qershor 2019
3. Raportimi i fundit lidhur me zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për rekomandimet e Raportit 2018 të Komisionit European, periudha 1 mars – 17 maj 2019.

Të pranishëm:

Gramoz Ruçi –	Kryetar i Kuvendit
Taulant Balla -	Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste
Nimet Musai -	Kryetar i Grupit Parlamentarë të Pavarur
Rudina Hajdari -	Kryetare e Grupit Parlamentarë Demokrat / Kryetare e Komisionit për Integrimin European
Elisa Spiropali –	Ministre për Marrëdhëniet me Parlamentin
Enver Rroshi -	Kryetar i Komisionit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shëndetësisë
Niko Peleshi -	Kryetar i Komisionit për Veprimtarinë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin
Arben Ahmetaj -	Kryetar i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave

Mungojnë:

Vasilika Hysi -	Zëvendëskryetare e Kuvendit
Ermonela Felaj -	Kryetare e Komisionit për Sigurinë Kombëtare

Mimi Kodheli - Kryetare e Komisionit për Politikën e Jashtme
Fatjona Dhimitri - Kryetare e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik
Ulsi Manja - Kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Marrin pjesë:

Mimoza Pano – Drejtore e Shërbimit të Seancës Plenare

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi - Hapim mbledhjen e Konferencës me këtë rend dite: Miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën 3 qershor - 12 korrik 2019, Miratimi i kalendarit tri javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 3 - 21 qershor 2019 si dhe Raportin periodik lidhur me zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për rekomandimet e Raportit 2018 të Komisionit Evropian për periudhën 1 mars - 17 maj 2019.

Me projektprogramin dhe projektkalendarin besoj jeni njohur në rrugë elektronike. Projektprogrami përfshin të gjitha çështjet e depozituara në Kuvend si projektligje, projektvendime, raportime etj.

Projektkalendari përfshin veprimtarinë në komisione dhe në seancë plenare. Janë parashikuar 2 seanca plenare përkatësisht në datat: 13 qershor 2019, ora 10:00 (e enjte) dhe 20 qershor 2019, ora 10:00 (e enjte)

Javën tjetër është menduar të mos ketë seancë plenare me qëllim që t'i lihet kohë e mjaftueshme komisioneve për të punuar meqënëse janë për shqyrtim 5 projektligjet e paketës MANIVAL, të cilat përcaktojnë standardet dhe nxisin zbatimin efektiv të masave ligjore, për luftën kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, financimit të përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë dhe kërcënime të tjera, që lidhen me integritetin e sistemit financiar ndërkombëtar.

Gjithashtu, është në procedurë shqyrtimi edhe Kodi Penal i cili po shqyrtohet aktualisht nga 5 komisione. Prandaj kërkoj nga komisionet e përhershme të përshpejtojnë punën me qëllim që të përmbushen afatet e përcaktuara në këtë projektkalendar për projektligjet e parashikuara, pasi miratimi i tyre lidhet ngushtë me afatet e kërkuara nga partnerët tanë ndërkombëtarë.

Sjell në vëmendje se jemi në përfundim të periudhës së raportimit të institucioneve që raportojnë në Kuvend, kështu që u kërkoj komisioneve të përhershme, të përshpejtojnë punën me institucionet që kanë mbetur për ta përmbyllur këtë proces (raportimin) brenda muajit qershor.

Kanë mbetur pa raportuar: KLSH, KLGJ dhe Këshilli i Ministrave për gjendjen në shërbimin civil. Pritet të depozitohet edhe raporti i KLP-së.

Keni ndonjë sugjerim? Materialet i keni të gjitha përpara.

Arben Ahmetaj – Jam zyrtarisht në kontakt me KLSH-në edhe me Kryetarin e KLSH-së, i cili ka kërkuar që raportimin e institucionit për veprimtarinë vjetore ka kalojë së bashku me projektligjin “Për buxhetin faktik”. Ky ishte diskutimi i fundit me Të. Kemi mundësi që raportimin ta zhvillojmë në bazë të kërkesës së Tij në fund të qershorit deri në javën e parë të korrikut, nëse është e mundur? Në këtë kohë mbyllet edhe raporti me ligjin organik “Për buxhetin faktik”, që i takon nga fundi i qershorit.

Gramoz Ruçi – Përse duhet të bëhen të dyja bashkë?

Arben Ahmetaj – Nuk është se është kusht. Kështu e kërkoi Kryetari i KLSH-së, në komunikimin zyrtar që bëra unë, sigurisht e kemi theksuar, brenda mundësive.

Rudina Hajdari – Në lidhje me projektligjin “Për rininë”, do të dëshiroja që ta shtynim ose të kemi disa seanca dëgjimore me shoqërinë civile, sepse kam marrë disa ankesa dhe këtu ka një lloj përplasjeje për sa i përket nismës së Këshillit të Ministrave. Nuk e di nëse do ta kemi nëpër komisione, por di që ka ardhur një kërkesë edhe për Komisionin e Integritetit që të dëgjohet aty. Duke qenë se unë jam përfaqësuese parlamentare e RAIKO-s, që është në kuadër të procesit të Berlinit, pra për rininë, shumë nga organizatat e shoqërisë civile më kontaktojnë lidhur me këtë projektligj, i cili ka ardhur nga Ministria e Arsimit. Por, Ministria e Arsimit nuk i ka përfshirë rekomandimet e shoqërisë civile në këtë projektligj. Prandaj, duke qenë se jam edhe përfaqësuesja e tyre në Berlin, njëkohësisht dhe Kryetare e Komisionit të Integritetit European mendoj se duhen marrë parasysh sugjerimet e tyre.

Gramoz Ruçi – Qartë, është në projektprogram dhe projektkalendar?

Mimoza Pano – Po Kryetar, është si në projektprogram edhe në projektkalendar. Në projektkalendar e kemi parashikuar si punë në komisione. Kemi parashikuar si komision përgjegjës Komisionin për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik dhe komision për dhënie

mendimi Komisioni e Ligjeve dhe Komisioni i Punës dhe Çështjeve Sociale, po shtojmë dhe Komisionin e Integritetit. Komisionet mund të planifikojnë organizimin e seancave dëgjimore. Nuk është planifikuar ende për në seancë plenare, prandaj i takon që të kalojë në muajin korrik.

Enver Rroshi – Së pari, Ju falënderoj për shtyrjen e projektligjit “Për ndryshime në Kodin Penal” në datën 13.06.2019. Me këtë hapësirë që na jepet, është koha e nevojshme për ta shqyrtuar në komisione me grupet e interesit.

Do të donim si komision të shqyrtonim projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 139/2015 “Për Qeverisjen Vendore”, pasi ka lidhje me çështjet sociale, punën dhe shëndetësinë.

Së dyti, projektligji “Për censusin e popullsisë dhe të banesave”, mund të kalojë ligji në komisionin tonë? Këto dy kërkesa kemi si Komision i Punës, Çështjet Sociale dhe Shëndetësisë. Faleminderit.

Mimoza Pano – Për sa i përket projektligjit “Për Qeverisjen Vendore” nuk e kemi planifikuar tek Komisioni e Punës dhe Çështjeve Sociale sepse objekti i ndryshimeve ka të bëjë me çështje të Ministrisë të Diasporës. Në këtë kuadër ndryshimesh kemi planifikuar Komisionin e Jashtëm, për dhënie mendimi dhe Komisionin e Ligjeve përgjegjës, meqenëse mbulon çështjet e Qeverisjes Vendore. Pra mund ta shtojmë Komisionin e Punës vetëm tek projektligji për censin, për dhënie mendimi.

Rudina Hajdari – Kërkesa për shkarkimin e Kryetarit të Komisionit Qendror të zgjedhjeve, thuhet se është bërë nga Kryetari i Grupit Partisë Socialiste. A mund të kemi një shpjegim për këtë kërkesë nga Kryetari i Grupit?

Gramoz Ruçi – Zoti Balla, çfarë është kjo kërkesë? Kërkesa për shkarkimin e Kryetarit të KQZ-së!

Taulant Balla – Ne e kemi thënë që në seancën plenare të dhjetorit 2017 që e kemi tërhequr kërkesën. Ka mbetur në program për efekt dokumentacioni. Do të bëjmë një kërkesë me shkrim, ku tërhiqemi nga kërkesa.

Gramoz Ruçi – Pra kërkesa është bërë përpara një viti e gjashtë muajsh dhe ka mbetur. Administrata është e detyruar që të gjitha kërkesat t'i përfshijë në program, por në rastin konkret përderisa nuk është shqyrtuar këto gjashtë muaj..... Sigurisht që propozuesi e ka

bllokuar këtë çështje dhe do të bëjë formalisht një kërkesë me shkrim për ta tërhequr kërkesën, kjo që të mos përsëritet më në programet e tjera.

Niko Peleshi – Një sugjerim kisha në lidhje me projektligji “Për disa ndryshime në Kodin Penal” si nismë deputetësh, mos ndoshta duhet të shkojë edhe në tek Komisioni i Integritetit, meqenëse në relacion shprehet për një transpozim të një direktive që lidhet me mjedisin? Nisma e deputetëve për Kodin Penal.

Ndërkohë edhe për nismën e 37 mijë zgjedhësve, përsëri për ndryshime në Kodin Penal “Për mbrojtjen e kafshëve” nëse mund të futet në axhendë. Ne e kaluam sot në parim dhe mesa pashë nuk është prezantuar në axhendë, por mund t’ia dalim.

Taulant Balla – Kini parasysh që, me datë 13 qershor në kalendar është përcaktuar shqyrtimi i nismës së deputetëve “Për ndryshim në Kodin Penal” dhe Komisioni i Ligjeve si komision përgjegjës, sepse Kodi Penal është një ligj i rëndësishëm dhe duhet të përfshijë edhe këtë nismë. Pra nuk mund të jetë një projektligj më vete, por duhet përfshirë si pjesë e të gjithë bllokut të ndryshimeve. Kërkesa jonë, për shkak të mungesës të Kryetarit të Komisionit të Ligjeve është që, Komisioni i Ligjeve ta marrë në shqyrtim edhe këtë propozim të zgjedhësve. Të kemi parasysh se në çdo rast është Komisioni i Ligjeve komision përgjegjës për përmbledhjen e të gjithave nismave që propozohen në të njëjtin ligj. Shumë mirë që komisioni juaj e ka përmbyllur dhe raportin përfundimtar t’ia dërgojë Komisionit të Ligjeve dhe ky komision ta shqyrtojë së bashku me ndryshimet e tjera.

Niko Peleshi – Ne në parim e kaluam dhe vendosëm që ta kalojmë te Komisioni i Ligjeve, por meqenëse nuk e pashë dhe është e ndarë në kalendar, mendova se mbase duhet bashkuar.

Gramoz Ruçi – Ndryshimet në Kodin Penal duhet të bëhen si paketë, pavarësisht se nismëtari është deputet apo janë votues.

Mimoza Pano – Kryetar, nismën me 37 mijë zgjedhës e ka shqyrtuar edhe Komisioni i Sigurisë i cili ka bërë dhe raportin gati dhe mund t’ia përcjellim Komisionit të Ligjeve.

Arben Ahmetaj – Kryetar, për projektligjet 1. “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, dhe “Gjikuria”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë koncesionare “Rruga Orikum - Llogara”, sh.p.k., për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrugës “Porti jahteve - By-Pass Orikum - Dukat (Ura e Shën Elizës)” dhe

2. “Për miratimin e kontratës së koncesionit/PPP, ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si autoriteti kontraktor, shoqërisë “ANK”, sh.p.k., si koncesionari, dhe shoqërisë “Bardh konstruksion”, sh.p.k., si shoqëria koncesionare, për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e segmentit rrugor Milot – Balldren”, do të doja t’i sugjeroja shërbimeve të Kuvendit që të vijnë vetëm tek Komisioni për Ekonominë dhe Financat, aq më tepër që edhe si procedurë janë procedura që shkojnë deri në Këshill të Ministrave. Është hera e parë ose jo, edhe për arsye se janë specifikisht me natyrë financiare, të mbeten vetëm tek Komisioni i Ekonomisë. Faleminderit.

Gramoz Ruçi – Mendime dhe sugjerime të tjera në lidhje me programin dhe kalendarin ka? Nuk ka, atëherë e mbyllim çështjet e programit dhe kalendarit. Meqenëse nuk ka kundërshtime projektprogrami dhe projektkalendari do ti kalojë seancës plenare si çështje në rend dite.

Lidhur me pikën e tretë në rend dite. Përpara keni raportimin periodik që bëjnë Shërbimet e Kuvendit lidhur me zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për rekomandimet e Raportit 2018 të Komisionit Evropian. Raportimi përfshin periudhën 1 mars – 17 maj 2019. Keni mendime apo vërejtje? Nuk ka, atëherë e mbyllim mbledhjen e Konferencës së Kryetarëve.

Falemnderit, mirupafshim nesër në seancë plenare dhe urime për rekomandimet, pasi sapo u shpall rekomandimi për hapjen e negociatave nga Komisioni Evropian, kuptohet.

MBLEDHJA MBYLLET